



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

AGJENCIA KUNDËR KORRUPSIONIT
AGENCIJA PROTIV KORRUPCIJE
ANTI - CORRUPTION AGENCY

DATË/A:	01.09.2014
REFERENC-Ë:	AKK- DPK- DPKPP
PËR/ZA/TO:	z. Afrim BAJRAKTARI Drejtor i Prokurimit në Universitetin e Prishtinës
CC:	z. Esat KEJMENDI Sekretar i Përgjithshëm në Universitetin e Prishtinës
NGA/OD/FROM:	z. Hasan PRETENI Drejtor i Agjencisë Kundër Korrupsionit
TEMA/SUBJEKAT/SUBJECT:	Opinion lidhur me Tenderin me titull " Sigurimi Fizik i Objekteve për nevojat e Universitetit të Prishtinës "

I nderuari z. Bajraktari ,

Në mbështetje të nenit 5 paragrafi 1 nën paragrafi 1.12 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit dhe nenit 19 paragrafi 1 nën paragrafi 1.6 të Ligjit nr. 04/L-051 për Parandalimin e Konfliktit të Interesit në Ushtrimin e Funkcionit Publik, lidhur me Tenderin " Sigurimi Fizik i Objekteve për nevojat e Universitetit të Prishtinës " me numër prokurimi: 90400-14-001-037 (Ri-tender) , Agjencia kundër Korrupsionit, ofron këtë:

OPINION

Në lidhje me monitorimin e tenderit me titull " Sigurimi Fizik i Objekteve për nevojat e Universitetit të Prishtinës " me numër prokurimi: 90400-14-001-037 (ri-tender) i iniciuar nga Autoriteti kontraktues Universiteti i Prishtinës.

A r s y e t i m

Universiteti i Prishtinës si Autoriteti kontraktues me dt.04.08.2014, përmes zyrës së prokurimit ka paraqitur kërkesë zyrtare në Agjencinë kundër Korrupsionit, përmes së cilës ka kërkuar që Agjencia të jetë pjesë e monitorimit lidhur me vlerësimin e tenderit me titull "***Sigurimi Fizik i Objekteve për nevojat e Universitetit të Prishtinës***" me numër prokurimi: 90400-14-001-037 (ri-tender). Gjatë monitorimit të kësaj procedure të prokurimit AKK ka konstatuar të faktet si në vijim:

Agjencia kundër Korrupsionit, ka marr pjesë në cilësinë e monitoruesit në vlerësimin e tenderit me titull "***Sigurimi Fizik i Objekteve për nevojat e Universitetit të Prishtinës***". Gjatë monitorimit të këtij procesi të prokurimit, Komisioni vlerësues ka konstatuar se 3 Operatorë ekonomik nga 5 OE që kanë tenderuar për këtë kontratë janë të përgjegjshëm, ndërsa 2 prej tyre nuk janë të përgjegjshëm pasi që nuk i përmbushin disa nga kërkesat të cilat janë caktuar në njoftimin për kontratë dhe dosjen e tenderit.

Për këtë aktivitet të prokurimit dosjen e tenderit e kanë tërhequr gjithsej 12 Operator ekonomik ndërsa ofertat për këtë kontratë i kanë dorëzuar 5 OE.

Komisioni për ekzaminimin, vlerësimin dhe krahasimin e tenderëve, pas vlerësimit të ofertave të Operatorëve Ekonomik që kanë ofruar tender të përgjegjshëm, konstatoi dhe erdhi në përfundim se Operatori ekonomik i renditur në numrin 1 në raportin e vlerësimit të tenderëve nga Operatorët e përgjegjshëm i plotëson të gjitha kërkesat e vendosura në dosjen e tenderit dhe ka ofruar çmimin më të lirë, andaj rekomandoi lidhjen e kontratës me këtë Operator. Agjencia kundër Korrupsionit pasi ka shqyrtuar dhe ekzaminuar me kujdes dokumentacionin e ofruar lidhur me këtë procedurë të prokurimit, dhe pas monitorimit që ka bërë në vlerësimin e këtij tenderit nuk ka gjetur prova të mjaftueshme me të cilat do të evidentohet ndonjë shkelje e dispozitave të LPP-së.

Në mbështetje të nenit 18 paragrafi 11 të Ligjit nr. 03/L-159 për Agjencinë kundër Korrupsionit, Agjencia mund të rihap rastin në çdo kohë nëse paraqiten rrethana të reja.

Me respekt !